



03/Nr. 5513/2023
Data: 05.07.2023

PROCESVERBAL I DEBATI PUBLIK

Mbajtur me datë 23.06.2023 në Sallën e Takimeve të Komunës së Hanit të Elezit. Ashtu siç ishte paralajmëruar nëpërmes informimit debati publik filloi në ora 14:00 prezent ishin 11 qytetarë të Komunës së Hanit të Elezit.

Takimin e kryesoj Drejtoresha e Administratës znjsh. Natyra Kalisi.

Rendi i Punës

1. Draft plani i veprimit për Transparencë 2023-2026 i Komunës së Hanit të Elezit.

Natyra Kalisi:- para se me filluar me prezantimin e Draft Planit të Veprimit për Transparencë fillimisht ftoj Kryetarin e Komunës që ta merr fjalën.

Mehmet Ballazhi:- mendoj që qytetarët janë të kënaqur për çështjen e transparencës dhe jemi të gatshëm me u ballafaquar me gjithë secilin për me i diskutuar problemet duke u bazuar në suazat ligjore. Ky plan është i bazuar në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale dhe në Udhëzim Administrative. Plani është diskutuar në Komitet për Politikë e Financa në Kuvend të Komunës dhe pas diskutimit publik do të përcillet për miratim në Kuvendin e Komunës. Më në detale drejtoresha mundet të na e prezanton planin.

Natyra Kalisi:- faleminderit Kryetar për pjesëmarrjen edhe pse ne prani shumë të vogël të pjesëmarrësve vlen të theksohet se Plani i Veprimit është një plan me rëndësi të madhe për komunën e Hanit të Elezit pasi që edhe njëra nga objektivat qeverisëse është rritja e transparencës në nivel lokal të komunës. Besojmë që ky plan i veprimit për transparencë do të jetë një ndihmesë në rritjen e efikasitetit të shërbimeve, në krijimin e një ambienti më transparent të punës në administratë, rritjen e besimit të qytetarëve ndaj të zgjedhurve të tyre publik.

Në plan janë të paraqitura objektivat ku objektivi kryesor i Planit të Veprimit për Transparencë Komunale është “të siguroj qeverisje të hapur për qytetarë, gjithëpërfshirje në procesin e planifikimit dhe zhvillimit të politikave, si dhe qeverisje transparente dhe llogaridhënëse.

Gjithashtu Plani ka të ndërthurur: Objektivat, Aktivitetet, Treguesit e matjes, Afati kohor, Njësia/personi përgjegjës, Mënyra e njoftimit /zbatimit, Dokumentet referuese, Formatit, Kolonë raportimi, për të cilat më detajisht e keni edhe planin brenda në dokumentet që ju janë shpërndarë materialet, nëse keni pyetje parashtroni dhe i diskutojmë.

Përndryshe në fund të vitit të kaluar komuna është shpërblyer me çmimin evropian për qeverisje ekselente ku njëra nga fushat ka qenë transparenca.

A keni ndonjë propozim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka ju faleminderit për pjesëmarrje.

Debati përfundoi në ora 14:20.

Procesmbajtësi

Avni Bushi



Drejtoresha e Administratës

Natyra Kalisi